



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 11, datë 26.09.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10²⁰)

Marrin pjesë:

- | | |
|----------------------|--------------------|
| 1.Simo Petromilo | 20.Besmir Brahimi |
| 2.Frosina Qyrdeti | 21.Ledja Shollaj |
| 3.Myzafer Elezi | 22.Vjola Xhafaj |
| 4.Vullnet Bilbilaj | 23.Aurora Qarri |
| 5.Bujar Osmënaj | 24.Erëmal Arapi |
| 6.Roland Strakosha | 25.Brikena Sika |
| 7.Elca Bezhani | 26.Anxhela Shenaj |
| 8.Edlira Kapllanaj | 27.Refie Laze |
| 9.Edison Kapaj | 28.Simbol Pazaj |
| 10.Rajmonda Zoto | 29.Eda Begaj |
| 11.Ervis Moçka | 30.Lorel Canaj |
| 12.Liljana Breshani | 31.Arsen Belaj |
| 13.Shkëlqim Leskaj | 32.Briseida Çakëri |
| 14.Illir Aliaj | 33.Marsela Dashi |
| 15.Endri Hyseni | 34.Anisa Ceno |
| 16.Gjergji Nika | 35.Grigor Dede |
| 17.Atird Hoxha | 36.Klodian Xhyheri |
| 18.Geron Gunbardhi | 37.Ardian Musta |
| 19.Englantina Imeraj | |

Mungojnë:

- 1.Sokol Kushta
- 2.Elpiniqi Mërkuri

- 3.Novrus Rrokaj
- 4.Brikena Puka
- 5.Gëzim Çapoj
- 6.Jerina Dervishaj
- 7.Eglantina Aliaj
- 8.Evis Allushi
- 9.Mujo Shakaj
- 10.Arjan Isufi
- 11.Dikens Bushaj
- 12.Liri Dëma
- 13.Eneida Vera
- 14.Alta Haluci



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 11/1, datë 26.09.2024

Z.Myzafer Elezi – Përhëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme. Fillojmë me miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, datë 22.08.2024.

Votohet.

Pro – 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Vazhdojmë me shprehjen e ligjshmërisë për VKB Nr 71-74, datë 22.08.2024 , ku janë shprehur të ligjshëm dhe me karakter individual, nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë (lexon shkresën)

Shkresa e dytë. Shprehje ligjshmërie për VKB Nr 75-83, janë vlerësuar të ligjshëm dhe me karakter individual nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.

Vijojmë me rendin e ditës.

Z.Gjergji Nika – Të mblidhet tre minuta Konferenca e Kryetarëve për një pikë të rendit të ditës, pastaj rendi i ditës.

Z.Ervis Moçka – Kjo pikë ka kohë që është diskutuar në Kryesi. Kur të vemi tek pika e rendit të ditës .

Z.Atird Hoxha – Është diskutuar , miratohet apo jo projektvendimi, jo rendi i ditës. Në komisione ka pasur diskutime nga këshilltarët.

Z.Ervis Moçka – Për procedurë. Ka kaluar në rendin e ditës.Për çfarë do diskutojmë dhe të mblidhemi. Të bëjë diskutimin, të bëjë propozimin zoti Gjergji, dhe të votohet.

Z.Atird Hoxha – Propozimi i zotit Nika ka të bëjë me rendin e ditës. Zoti Elezi, nëqoftëse miratohet rendi i ditës, s’kemi ç’ të diskutojmë tek pika. Nëqoftëse, komisionet e këshillit e kanë vendosur të reflektohen ndryshimet në këtë projektvendim, administrata nuk i ka reflektuar.

Në këtë moment Konferenca e Kryetarëve ka të drejtë të mblidhet, për reflektimet e kërkuara . Siç është vendosur për rendin e ditës në Konferencën e Kryetarëve.. Dhe Konferenca e Kryetarëve, dhe vendimin e propozuar ...Pse mos të mblidhet Konferenca e Kryetarëve, për procedurë.

Z.Myzafer Elezi – Nga administrata e bashkisë , ka ardhur një material me ndryshimet e reflektuara, në lidhje me krijimin e Sh.A-së.

Z.Ervis Moçka – Ka një propozim nga zoti Nika. Por nuk kuptohet propozimi. Nuk ka llogjikë, të mblidhet Konferenca e Kryetarëve për një pikë. Kur të vijë pika për diskutim. Pra, propozon që të mblidhet Konferenca e Kryetarëve ..Le të propozohet për ta hequr nga rendi i ditës. Pse do mblidhet Konferenca. E mbledhim kur shtojmë ndonjë pikë, për një vendim të ri.

Z.Atird Hoxha – Zoti Myzafer e thotë, që ka ardhur nga administrata materiali.Nuk jemi njohur, pra, të votohet apriori? Nuk i kemi ndryshimet e reflektuara. Propozimi im është të mblidhet Konferenca e Kryetarëve.

Z.Daut Zëraj – Për procedurë. Rendi i ditës me 9 pika ka kaluar, pra, mund të propozohet të hiqet një pikë.

Z.Ervis Moçka – Nëqoftëse, administrata ka sjellë materialin me ndryshime,... në komisione ka thënë, do ta rishikojmë. Pika ka qenë në rendin e ditës. Pra, mund të miratohet me ndryshime. Pra, ngrihet me propozim të hiqet pika nag rendi i ditës.

Znj.Anxhela Shenaj – Në komision është diskutuar dhe është shprehur që, ky material nuk ishte i punuar mirë dhe analizuar mirë, nuk duhet të futet në rendin e ditës.

Z.Erëmal Arapi – Për atë që sapo na relatoi zoti drejtues i seancës, kur do njihemi me këtë material..Nga administrata na vjen materiali në mbledhje.

Z.Ervis Moçka – Kanë ardhur me strategji për një pikë që nuk e futëm në rendin e ditës. Ishte projektvendimi i hartëzimit. Ai nuk ka ardhur.Ky projektvendim nuk ka ardhur. Ky është kundërshtuar në komision , nuk ka ardhur.

Z.Atird Hoxha – Për të thënë të vërtetën, zoti Moçka s’ka qenë dakort me Statutin. Nëqoftëse, zoti Moçka nuk do të mblidhet Konferenca e Kryetarëve , të shprehi mendimin e tij që, nuk do të mblidhet Konferenca e Kryetarëve.

Znj.Frosina Qyrdeti – Më është paraqitur në mënyrë shkresore me pika. Mendoj që, s’është serioze, komentet të bëhen kur të vijë radha e pikës së rendit të ditës.

Z.Myzafer Elezi – Ka një kërkesë nga administrata , për heqjen e pikës 9 të rendit të ditës. Kush është dakort me rendin e ditës?

Votohet.

Pro – 26 vota

Kundër – 2 vota

Abstenim – 2 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 11/2, datë 26.09.2024

Z.Myzafer Elezi – Pika 1 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin gusht 2024”. Është projektvendim i përmuajshëm .
E kalojmë në votim ?

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

BASHKIA VLORE
KESHILLI I BASHKISE

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 11/3, datë 26.09.2024

Z.Myzafer Elezi – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin gusht 2024”.
Do e kalojmë në votim ?

Votohet.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 11/4, datë 26.09.2024

Z.Myzafer Elezi – Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e listës për fëmijët e familjeve që kanë nevojë për kopësht dhe çerdhe, përfitues të programit të Qendrës Psiko Sociale “Vatra”.

Ta hedhim në votim, apo ka pyetje, diskutime ? - Jo.

Votohet.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 11/5, datë 26.09.2024

Z.Myzafer Elezi – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve që, përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.

Është e njëjta procedurë. Nga kryetarët e grupeve, kush e do fjalën ?

Z.Endri Hyseni – Përfituesit kanë plotësuar kriteret .

Z.Myzafer Elezi – E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 11/6, datë 26.09.2024

Z.Myzafer Elezi – Pika 5 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e Programit të Buxhetit Afatmesëm 2025 –2027 “.

Z.Kozma Mali – Jemi bazuar në Udhëzimin Nr 23/2018 të Ministrisë së Financave si, dhe në udhëzimet plotësuese, për hartimin e PBA 2025 – 2027. Në funksion të kësaj procedure, është miratuar dhe kalendari, i dërguar në Ministrinë e Financave. Kanë ardhur dhe rekomandimet. Këshilli ka miratuar dhe tavanët përgatitorë..Treguesit kryesorë janë bazuar në 3-vjeçarin e fundit. Ky projekt do të dërgohet dhe Ministrisë së Financave dhe do silllet për miratim. Janë marrë parasysh dhe kërkesat e qytetarëve gjatë degjësave publike.

Znj.Elca Bezhani – Në relacion shpjegohet qartë. PBA 2025 – 2027 ka kaluar të gjitha hallkat. Është nisur dhe në Ministrinë e Financave, ku dhe më pas kanë ardhur dhe rekomandimet. Janë miratuar dhe tavanët, duke pasur parasysh, bazuar dhe në Buxhetin e Vitit 2024. Duke parë shifrat dhe ndryshimet , u diskutua nga anëtarët e komisionit të Financave dhe i'u kërkua administratës, të sqarohen këto ndryshime. Duke qenë se, dhe NSHP është pjesë e bashkisë, dhe dy herë ka pasur rritje pagash, duke menduar për sqarimin e këtyre ndryshimeve.... Menduam të kalojmë në mbledhjen e këshillit.

Z.Gjergji Nika – E diskutuam, çdo tabelë është marrë nga Ministria e Financave, jo, sqarime shtesë për çdo tabelë. E thashë dhe në mbledhjen e komisionit . I sqaroni dhe për buxhetin.

Për vitin 2025 , me rritjen e pagave, juve ju rriten dhe shpenzimet e pagave, me 70 milion lekë/reja. Keni një kërcitje prej 53%...Kjo për Buxhetin e vitit 2025, pra, do pasur kujdes në Buxhetin e vitit 2025 për pjesën tavanore, afatmesme, përfundimtare.

Z.Myzafer Elezi – Pyetje, diskutime ? –Jo.

Kalojmë në votim.

Pro – 26 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 7 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 11/7, datë 26.09.2024

Z.Myzafer Elezi – Pika 6 e rendit të ditës, projektvendimi “ Për disa ndryshime në VKB Nr 92, datë 24.11.2023 “ Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024, I ndryshuar “.

Kush e do fjalën?

Z. Endri Hyseni – Ky projektvendim është diskutuar dhe në Komisionin Juridik. Është një projektvendim nga administrata, në zbatim të VKM. Ky vendim është pasqyruar , vetëm me një ndryshim të vogël për Administratorët e njësive, paga nga 155 mijë të bëhet 145 mijë, Të reflektohet në zbardhjen e vendimit. Është përlllogaritur në sajë të ndarjes së niveleve të bashkive , bazuar në konkurrencën në treg. Është marrë maksimumi . Në zbatim të këtij projektvendimi, propozoj ta miratojmë që ti hapim rrugë, rritjes së pagave.

Z.Erëmal Arapi – Ky projektvendim është zbatim i VKM Nr 503/2024 “Për disa ndryshime ...” Mbi ç’bazë është bërë, që kanë kaluar në masën maksimum.. Efektet fillojnë që në datën 1 Shtator. Shikoj që paga e këshilltarit të kryetarit, e ka pagën të njëjtë me drejtorët.

Pra, mbi ç’kriter , pse në kufirin maksimal rritja e pagave dhe, efektet që fillojnë që në datën 1 Shtator.

Znj.Laura Brinja – VKM –ja për rritjen e pagave , ka nivel minimal dhe maksimal, kjo edhe për ti stimuluar për punë sa më të mirë. VKM-ja hyn në fuqi që prej datës 1 Shtator.

Z.Erëmal Arapi – Për punë sa më të mirë keni vajtur tek maksimumi, apo për tu motivuar ? Pse po veni në maksimum?

Z.Erëmal Dredha – E para, pse jo? Edhe po të ishte më pak se maksimumi, do të thoshit pse nuk jepni maksimumin.

Pra, është paga bruto, jo neto që merret në dorë. Ka rritje progresive për të gjithë punonjësit. Administrata meriton të paguhet. Kur është mundësia .., Ne kemi bërë kalkulimin. Ka një grant nga qeveria dhe një pjesë nga nga buxheti i bashkisë. S’ka ndonjë gjë tjetër. Pagat do trajtohen , sipas kalkulimeve të VKM.

Z.Gjergji Nika – Për ngritjen e pagave është zbatuar VKM. Bashkia ka zbatuar VKM-në . Gjithmonë kam diskutuar për rritjen e pagave, që nga sanitarja. Shoh që rritja, për kategoritë;

-Specialist – 36 %

-Specialist – 26%

-Përgjegjës finance – 32%

-Drejtor i përgjithshëm – 52%

-Administrator – 63%

-Sekretar i këshillit – 87%

-Këshilltar – 96%

-ZëvendësKryetar – 71%

-Kryetar – 64%

Jam partizan i rritjes së pagave, por nuk më vjen mirë që, një punonjësi i zjarrfikëses , apo sanitarja, që kërkojnë të shihet paga e tyre., apo gjithë punonjësve të shërbimeve. Ne po rrisim pagat e linjës së parë. Po për këta të tjerët ? Të rritet paga në çdo aspekt edhe për zjarrfikësen, edhe për sanitaren ..Në komision kam thënë , ose të rritet paga e drejtorit, ose të ulet paga e këshilltarit të kryetarit. Le të ulet paga e këshilltarit, të jetë një diferencë. Ne si këshilltarë duhet të jemi të kujdesshëm në vendime dhe veprime. Patjetër që do të rriten pagat, por të preken edhe ata , do të demoralizohen.

Z.Atird Hoxha – Përsa i përket këtij projektvendimi, vota ime është kundër, pasi pagat do rriten vetëm për oborrin e bashkisë. Pse duhen këshilltarët , që me këto paga mund të bëhen një rikonstruksion i një shkolle apo kopshti, etj..Këtu nuk preken të gjitha shtresat. Këto rritje, zoti Nika që i përmendi në përqindje, është rritje shumë e konsiderueshme. Pra, nëqoftëse një pjesë t'ju shpërndahej punonjësve të shërbimeve. Nuk mund të dëgjojnë këto shtresa si, ata me ndihmë ekonomike gjithë këto rritje dhe për këto shtresa nuk ka rritje.

Unë mendoj , qytetarët na dëgjojnë dhe do mendojnë . Jam kundër këtij projektvendimi, pasi kjo rritje nuk shkon.

Z.Geron Gunbardhi – Për të mos përsëritur , për sa u tha, edhe vota ime është kundër .Pse vajtët në maksimum, kësaj pyetje nuk i'u përgjigj dhe drejtoresha. Është gjë e mirë, rritja e rrogave, por ke punonjës të NSHP që nuk marrin rrogat, punojnë dhe ditë të diela, me orar dhe pa orar.

Jemi për Policinë Bashkiake, po arkëton 30-40 milion dhe rrogat nuk u rriten. Nuk menduat për rrogat e tyre, sikur një 10 mijëshe, minimale për punëtorët.

Z.Illir Aliaj – Po trumbetohet me të madhe rritja e pagave. Është indeksim pagash. Specialistët si të Tiranës dhe të Vlorës të jenë njësoj. Do falënderuar administrata që ka mbledhur të ardhurat, që i përballon dhe me buxhetin e saj. Jam i mendimit ta kalojmë . Është indeksim pagash.

Znj.Elca Bezhani – Është njehsim pagash.

Z.Shkëlqim Leskaj – Është ngritur paga jo vetëm për administratën , por dhe deri tek punonjësi më i thjeshtë. Jam dakort dhe me zotin Ilir, ta kalojmë në votim.

Znj.Laura Brinja – Përsa i përket pagës së zjarrfikëses, ka kaluar në këshill bashki dhe kanë ndryshuar. Rritjen e kanë përfituar që nga 1 Korriku.Për punonjësit e shërbimeve , merret sipas treguesve , orëve jashtë orarit. Në lidhje me Policinë bashkiake, kemi dërguar shkresë në ministri dhe po presim. Dhe do vijmë më vonë në Këshillin e Bashkisë.

Z.Ervis Moçka – Pra, dinjiteti vihet me punën e vet. Në rastin që qeveria rrit pagën..,por u bë diskutimi për një grup shumë të ngushtë. U fokusuat tek këshilltari i kryetarit. Është qeveria, i ka kategorizuar që gjithëkush ta bëjë punën e vet me dinjitet. Të bëhet dhe shërbimi më i mirë për qytetarët. Mos e kapni me pozicionet, nëqoftëse keni ndonjë emër konkret, po. T'ju japim mundësinë të punojnë me dinjitet.

Z.Myzafer Elezi – E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 26 vota

Kundër – 4 vota

Abstenim – 4 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 11/8, datë 26.09.2024

Z.Myzafer Elezi – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 29.12.2023 “Për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2024 “.

Z.Kozma Mali – Është granti..Efekti irritjes së pagave 48milion 212 mijë lekë/reja; ku 14.199 nga granti i pakushtëzuar dhe 34 milion lekë/reja nga buxheti. Artikulli 600, 602.

Z.Gjergji Nika – Pra, granti nga qeveria 14.200; 6 milion lekë/reja, jo 34...Rritja është 34 milion lekë/reja . Fondi i pagave për 4 mujorin është 48 milion lekë/reja.

Shikoni tek buxheti, kini kujdes se nga 4 milion do shkojë 5.5milion.

Z.Myzafer Elezi – E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 6 vota

Abstenim – 2 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 11/9, datë 26.09.2024

Z.Myzafer Elezi – Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës, në projektvendimin “Për krijimin e Shoqërisë “VLORA PARKING “ SH.A, si person juridik në pronësi të Bashkisë Vlorë dhe miratimin e statutit” .

Z.Dorian Demiri – Projektvendimi vjen si propozim për krijimin e një Sh.A-je, për parkimet në qytet. Bazuar në Ligjin 9901, Ligji “Për Shoqëritë Tregëtare”. Kapitali rreth 3.5 milion lekë /reja. Në komisione për Statutin konstatuan dhe kërkuan disa sqarime si, kemi përcaktuar ligjin, “Për Shoqëritë Tregëtare “. Në Statut , Këshilli Mbikqyrës apo Këshilli Administrativ, QKR apo QKB...Të gjitha këto ndryshime janë pasqyruara në Statutin e ri që kemi depozituar .

Z.Atird Hoxha – Ky projektvendim për fat të keq, është kundër interesit të qytetarëve.Ky projektvendim kërkon dëgjuesë publike. Për fat të keq , dëgjesat, këto nuk mund të konsiderohen dëgjesa. Kjo bëhet sa herë për projektvendimin që e kërkon ligji. Nuk duhet të diktohen këto lloj projektvendimesh dhe pse në numër dhe forcën e kartonit nga ana juaj, për parkimin me pagesë . Kush nga ju është i gatshëm , që për të gjitha këto rrugë , vendparkimet me pagesë .., që secili të paguajë parkimin. Asnjë nga ne nuk është i gatshëm që të jemi entuziastë, për vendparkimet me pagesë. Ne nuk jemi dakort si PD me këtë projektvendim, për tarifimin e rrugëve. Nuk jemi kundër një plani politikash , por jo në një mënyrë ku vendosen taksat për qytetarin e Vlorës.

E kam studiuar dhe është një copy past e “Tirana Parking”. Në këtë relacion , administrata thotë , të rrisim ca të ardhura...Në relacion, thuhet se, ka një kaos në qytet. Faji është i administrimit, kryesisht i Policisë Bashkiake. Në të gjitha lagjet ka kaos. Tarifimi i rrugëve detyron drejtuesit e mjeteve , të shkojnë nëpër lagje , lagjet janë në kaos. Sheshi para stadiumit “Flamurtari “, Zjarfikëses, nuk del dot..Nëqoftëse, do miratoni këtë projektvednim, nesër ...Pra, nëqoftëse do tarifohen rrugët kryesore, lagjet do jenë në makth e kaos.

Për të përfunduar, ky projektvednim është në dëm të qytetarëve. Është i pastudiuar, është në dëm të qytetarëve, shton taksat dhe tarifat për ta. Barra për ta është rritur 3%.

Z.Ermal Dredha – Ne jemi munduar të zbatojmë ligjin. Njoftimet për dëgjesa janë bërë. Varet nga interesimi i qytetarëve. Është hapi i parë, krijimi i shoqërisë, më pas do studiohet harta. Do trajtohen dhe rezidentët , që mos të kenë kosto financiare. Një familje ka më shumë se një makinë si dhe trafiku problem. Parkohet dhe atje ku s’duhet. Nuk ka dhe ndonjë reagim nga qytetarët. Vlora po zgjerohet dhe shtohet , lind nevoja që të shikohet mundësia e rritjesKemi bërë kërkesat përkatëse, të bëhet dhe një by-pass tjetër për të përmirësuar trafikun. Nuk ka qytet që nuk e ka filluar këtë procedurë. Nuk është vetëm për të shtuar punonjës. Bëhet për të rregulluar trafikun. Sh.A –ja vetë, do gjenerojë të ardhura për të përmirësuar infrastrukturën,

sinjalistikën , vendosjen e semaforëve, por çdo gjë do kohën e vet. Duhet një studim. Kudo ndiqet kjo procedurë me pagesë, do jetë i përballueshëm si tarifim.

Z.Endri Hyseni – Përsa i përket këtij projektvendimi, sot po doskutojmë vetëm krijimin si Sh.A. Ndërsa të tjerat do të diskutohet në mbledhjet në vijim, se si do të funksionojë. Projektvendimi ka disa të mira, se duke pas një tarifim do të kemi përmirësim të shërbimit, kërkesë kjo dhe nga grupet e interesit dhe bizneset.

Znj.Eda Begaj – Doja të tërhiqja vëmendjen e administratës, ka shumë qytetarë që kanë probleme të ndryshme. Unë nuk jam kundër sjelljes së këtij projektvendimi . Parkimi është problem në qytet. Ne s’kemi parkime publike. Duhet krijuar një infrastrukturë, ende nuk kemi ku të parkojmë. Janë ndërtuar pallate , por s’kanë vendparkime, s’kanë infrastrukturë.

Z.Ermal Dredha – Vlora është pothuajse e paprekur , është zhvilluar më pak në ndërtim.

Vlora është në zhvillim. Gjithë ndërtesat, minimumi do bëhen 2kate nën dhe parkim.

Kjo Sh.A ka për detyrë të evidentojë këto hapsira. Më vonë një plan biznesi, një plan studimi .

Znj.Eda Begaj – Ato që do të ndërtohen të kenë shesh parkimi. Ky projekt është bërë më parë. Le të ndërgjegjësohen qytetarët më parë, pastaj gjithësecili të tarifohet apo taksohet në mënyrën e vet.

Z.Ermal Dredha – Prandaj do krijohet kjo Sh.A. Do ketë studim më të thellë. Duhet kohë, do bëhet me zona. Rezidentët do pajisen me karta. Duke e menaxhuar ne, do jetë më mirë sesa privati. Publike 100% që do ti mbetet Vlorës.

Znj.Liljana Breshani – Miratoj dhe e vlerësoj këtë projektvendim. E shoh këtë Sh.A në përmirësimin e trafikut, shërbimin urban ...Më vjen shumë keq që nuk dini ku jetoni. Prezenca e shumë mjeteve në qytet , tregon që ky qytet ka zhvillim, standart jetese. Jetojmë në kapitalizëm, kemi njerëz të aftë dhe të paaftë.

Z.Arsen Belaj – Ky projektvendim “Vlora Parking”, i kap njësitë ?

Do isha i mendimit të bëhet një studim, në verë ka shumë trafik. Do isha i mendimit , të ishit shumë i qartë mbas krijimit të shoqërisë. Nuk jam kundër krijimit të kësaj shoqërie. Nuk ka parkime..Nuk jam kundër krijimit të shoqërisë, por duhet të ketë disa rregulla të forta.

Z.Geron Gunbardhi – Vota ime është pro.Ka shumë që nuk janë dakort me këtë projektvendim. Ka kaos, s’jam kundër . Ju ftoj si fillim të rregullohen rrugët, të ndërhyjnë nëpër lagje. Nuk mundet që Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit të jenë grabitës të qytetarëve. Në fillim të rregullohet transporti për qytetarët, të rregullohet trafiku...Vota ime është pro, ta ngremë këtë shoqëri. Të mblidhen, të fillojë bulevardi me pagesë, bëni ca takime me qytetarët. Ti hedhim hapat një nga një. Ti dërgojmë shkresë Policisë së Shtetit , për mëngjeset kryesisht, është shumë problem.

Z.Ermal Dredha – Hapi i parë është krijimi i Sh.A-së si fillim, pastaj do bëhet studim. Mund të shikohet pjesa e qendrës së Orikutit, në sezonin turistik.

Z.Gjergji Nika – Shumica kanë aplikuar për investitor strategjik, taksa 10-12%...

Zoti Kryetar! Keni 3 sfida këtë 4 –vjeçar;

-Pastrimin

-Parkimin

-Menaxhimin

Duke ju futur pjesës së analizës së krijimit të shoqërisë, është e gabuar..Kaq rrugë – 21..., duhet të bëhet analizë. Bëhet analiza si fillim, pastaj krijohet shoqëria...Kaq makina, kaq të ardhura..Diskutuam që Qendra e Trajtimit të Studentëve, ishte debitore me 98 milion lekë/reja. Problemi qëndron tek krijimi i shoqërisë. Statuti duhej të ishte argumentuar më mirë. Prandaj kërkoja të mblidhet Konferenca e Kryetarëve dhe të tërhiqet ky Statut .

Të bëhet diçka e mirë nga ana ligjore. Duhet bërë për të rregulluar, patjetër për të rregulluar. Qepeni Statutin. Statuti nuk është i mirëfilltë në shumë pika. Nuk është krijuar akoma shoqëria , ti ke krijuar Këshillin Mbikqyrës , pa mbledhur Asanmbleja .

Z.Dorian Demiri – Është përcaktuar në ligj. Në Statut, në mbledhjen e parë të Asanmblesë, mund të ndryshojë Këshillin Mbikqyrës. Përcaktohet në ligj, hera e parë në Statut.

Z.Gjergji Nika – Statuti do riparë, të qepet në mënyrë të saktë, pasi do ngelet më vonë. Tërhiqe dhe bëje nga e para...Ndryshon thelbi i Statutit. Pjesa tjetër, duhet të cilësohet një pikë në Statut “..kur kalojnë në Këshillin Mbikqyrës që ka tagrin të bëjë ndryshime...”, Statuti duhet kufizuar , Këshilli Mbikqyrës duhet kufizuar, pra që , shpërndarja dhe shitja e aksioneve , të jetë tagër i Këshillit Bashkiak , bazuar në Ligjin Nr 139/2015 ...Në momentin që Këshilli Mbikqyrës , që ka tagrin, nuk kalon gjë në këshill.

Pra, të cilësohet pika në Statut ,” ..ndryshimi i aksioneve të bëhet nga Këshilli i Bashkisë, tagër e Këshillit të Bashkisë , ndryshimi i aksioneve të shoqërisë”.

Duhet bërë një plan i mirëfilltë studimi. E keni modelin, Merkatën e Peshkut. Nuk duhet të ketë gjë evazive, gjëra konkrete.

Z.Erëmal Arapi – Do ta votoj kundër, sepse ju këtë ndërmarrje, do ta keqmenaxhoni. Vlora në këtë gjëndje , është nga administrimi juaj. Janë bërë 3 investime , në 3 sheshe . Ky qytet do një studim. Në çdo vend ka parkim me pagesë. Do një studim. Rrugët i këni sjellë ? Nuk kemi një parkim publik, ka ndonjë pa lekë?

Z.Ermal Dredha – Po, janë për invalidët, për disa shtresa.

Z.Vullnet Bilbilaj –Si një njohës i mirë i Ligjit 9901”Për formimin e Shoqërive Tregëtare “.., kjo pjesë, është vetëm teknike. Ky Ligj, 9901, nuk të lë të dalësh jashtë kornizave, por veçanërisht Neni 4 të rishikohet dhe ta saktësojnë në përputhje me objektivat e veprimtarisë. Them ta miratojmë , ta kalojmë .

Z.Klodian Xhyheri–E parashikova parkimin me pagesë.Në këtë projektvendim shohim vetëm majën e ajzbergut, pra krijimin e shoqërisë dhe disa objektiva. Në radhë të parë duhet ti krijojmë kushte qytetarëve, për transport të shpejtë. Po të ishin këto mjete të shpejta, shumë nuk do ta përdornin makinën e tyre. Duhet të ketë parkim me pagesë ..Çfarë do ndodh ë, nëqoftëse 90-95% e rrugëve do bëhen me pagesë. Qytetari, pasi rrugët kryesore të mbushen, do kalojnë dhe do dynden nëpër lagje e rrugë.... Vota ime është kundër. Doni ti taksoni.

Z.Ermal Dredha – Idea është , kemi diskutuar bashkë dhe më keni thënë që, ka ardhur koha për parkimet me pagesë. Idea është , e kemi thënë , po përsërisim shumë herë. Do kalojë krijimi i Sh.A, më pas do diskutohet shumë, do bëhet një plan studimi.Do shihet mundësia dhe e parkimit publik.

Z.Ervis Moçka – Ndoqa me vëmendje të gjitha diskutimet.Dua ti shoh si bashkëpunëtorë. U qartësua shumë herë dhe u tha shumë herë , që është vetëm krijimi i shoqërisë Sh.A, nuk kemi as hartat . Është thjesht vetëm fillimi i një gjëje. Nuk është një projektvendim i thjeshtë , ndërhyr tek banorët, tek cilësia e jetës së tyre.

Duhet analizuar mirë. Por, Kryetari tha, kur të vijmë në hapin tjetër, për rrugët do të bëhet një analizë, një plan biznesi ...derisa të vijë.. Të bëhet një analizë e mirëfilltë me relacion të detajuar para qytetarëve. Të gjitha këto do mblidhen, do parashikohen, pra rrugët, tarifat etj..

Të mblidhet një grup pune i mirëfilltë teknik dhe në konsultime publike dhe me këshilltarë. Sot krijohet një Shoqëri Aksionere , për të bërë një studim të mirëfilltë. Por, sot, duhet të shohim Statutin. Çfarë përcaktohet në Statut, me një apo dy nivele...., administratorët e parë, pra për çështje teknike , duhet të diskutonim sot. Jam shprehur kundër projektvendimit për hartat e rrugëve , që të vijë në moment tjetër, i analizuar shumë mirë .

Z.Gjergji Nika – Propozim për Kryetarin dhe Drejtorinë e Urbanistikës. Në kohën e zotit Leli, është diskutuar për krijimin e dy parkingjeve të nëndheshëm. Nuk u bënë.

Jam i mendimit të bëhet parkim me kate, kjo zgjidhet vetëm me investitorët. Të bëhen karabina, ka shumë asete të bashkisë, ka pika strategjike për krijimin e parkimeve me kate.

Z.Atird Hoxha – Në pikën 4 të projektvendimit ,lexon ...kapital prej 3.5 milion ..Në buxhet nuk thuhet. Si do operohet.

Z.Dorian Demiri – Do shohim në buxhet.

Z.Myzafer Elezi – E kalojmë në votim me dy propozimet e bëra nga zoti Bilbilaj, për ndryshimin në Nenin 4, dhe propozimin e zotit Nika .

Pra e votojmë me ndryshimet e bëra , ndryshimet e propozuara.

Votohet

Pro – 27 vota

Kundër – 5 vota

Abstenim – 2 vota

Miratohet.

